



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 5572 Prot.,  
11

Tiranë, më 24/12 2020

URDHËR

Nr. 567, Datë 24, 12, 2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 473, DATË 20.11.2020 “PËR  
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR MARRJEN E  
LICENCËS PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORIT,  
RIPËRTËRITJEN E SAJ, SI DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE  
PROCEDURAVE PËR PEZULLIMIN DHE HEQJEN E LICENCËS NË ZBATIM  
TË LIGJIT NR. 35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE  
TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO”**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 53 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenit 156 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 472, datë 19.11.2020 “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe në vijim të kërkesës nr. 5572 prot., datë 23.12.2020 “Kërkesë për shtyrjen e afatit të afatit për plotësimin dhe dorëzimin e dosjes së plotë të aplikimit për licencimin e Agjencive të Administrimit Kolektiv”,

**URDHËROJ:**

1. Shtyrjen me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike të afatit për depozitimin e kërkesave dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim parashikuar në Udhëzimin nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” të Ministrit të Kulturës.

2. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për komunikimin dhe zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Elva MARGARITI

